



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
*REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO*

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**

---

Numri i lëndës: 2023:201123  
Datë: 06.03.2024  
Numri i dokumentit: 05418870

**PPP.nr.102/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Sami Gashi, me bashkëpunëtoren profesionale Rona Myftiu, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KESco) me seli në Prishtinë, kundër debitorit K.Z., (Qerdhja-DKA) me adresa .....-Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat A.A., nga Prizreni, duke vendosur për prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.141/23 të datës 23.03.2023 të lejuar nga Përmbartuesit privat, Enis Hoxha nga Prizreni, jashtë seancës dëgjimore me datë 06.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.PRANOHET** si bazuar prapësimi i debitorit K.Z., nga Prizreni, **ANULOHET** urdhri përmbartimor P.nr.141/23 të datës 23.03.2023 të lejuar nga Përmbartuesit privat, Enis Hoxha nga Prizreni, dhe **PËRFUNDOHET** në tërësi procedura përmbartimore në këtë çështje përmbartimore.

**A r s y e t i m**

Kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KESco) me seli në Prishtinë, ka parashtruar propozim për përmbartim në zyrën e përmbartuesit privat Enis Hoxha nga Prizreni, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori i përmbartimit K.Z., (.....-DKA) me seli në Prizren, që brenda afati prej 7 ditësh t'ia paguaj shumën prej 8,759.82 euro me kamatë prej 8% për periudhën nga data 22.02.2016 deri më datë 08.02.2023, kur borxhi është bërë i arritshëm për pagesë e deri në ditën e pagesës së tërësishme, dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, përmes bartjes së të hollave të debitorit në xhirollogari të kreditorit, si dhe përmes shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Përmbartuesi me datën 23.03.2023 ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.141/2023, me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbartimin sipas Propozimit të kreditorit.

Me datë 21.08.2023 debitori ka paraqitur prapësimin me të cilin në tërësi e ka kundërshtuar urdhrin për përmbarrim P.nr.141/2023, me pretendimet se propozimi për përmbarrim i kreditorit është i pabazuar për faktin se nuk është mbështetur në dispozita të nenit 38 dhe 40 të LPP-së, duke shtuar se debitori nuk është përgjegjës për detyrimin ndaj kreditorit, për shkak se debitori për periudhën në të cilën kërkohet detyrimi, i njëjti nuk ka banuar në atë paluajtshmëri. Debitori në prapësim po ashtu i ka bashkangjitur provat me të cilat e ka kontestuar në tërësi urdhërin për përmbarrim. Andaj nga këto pretendime ka kërkuar që gjykata në tërësi ta aprovoj prapësimin dhe ta shfuqizojë urdhrin për përmbarrim P.nr.141/23 të datës 23.03.2023.

Në përgjigjen e prapësimit të kreditorit të datës 22.08.2023, i njëjti, prapësimin e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar përmes asnjë prove. Ka shtuar se propozimi për përmbarrim është bërë në përputhje me nenin 29 dhe nenin 40 të LPP-së, andaj ka propozuar që urdhri për përmbarrim të mbetet në fuqi.

Gjykata me datën 22.01.2024 e caktuar dhe ka mbajtur seancën dëgjimore, ku në këtë seancë kanë prezantuar të autorizuarit e palëve ndërgjyqësve, për kreditorin Çlirim Rexhi – zyrtar ligjorë pranë kreditorit, ndërsa për debitorin ka prezantuar i autorizuari i tij av. Alija Ajro nga Prizreni.

**I autorizuari i kreditorit në seancën dëgjimore ka deklaruar:** Mbetem në tërësi pranë propozimit për përmbarrim dhe përgjigjes në prapësim, pasi që propozimi është ushtruar konform procedurave ligjore në përputhje me nenin 29 dhe 40 të LPK-së, përfshirë nenin 341 të LPP ku kreditori nga përmbarruesi privat ka kërkuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm përkatësisht ekstraktin nga librat afarist me numër DPZ-144598 për periudhën kohore 22.02.2016 e deri me datën 08.02.2023, dhe borxhi i përgjithshëm është në vlerë: 8,759.82 euro, si rezultat i shpenzimeve të krijuara nga ana e debitorit K.Z.,. Ndërsa pretendimet e debitorit sa i përket se ky borxh nuk i përket atij dhe nuk ka qenë shfrytëzues ai, konsiderojmë se ky pretendim nuk mund të merret për bazë, sepse në historikun e konsumatorit, i njëjti asnjëherë nuk ka bërë kërkesë për ndërrim të emrit, siç parashihet në procedurën për mbylljen e llogarisë së konsumatorit dhe aktivitetet e ndërlydhura. Prandaj pronari është i njëjti që nga dita e nënshkrimit të kontratës. Ndërsa Aktgjykimet që i ka siguruar debitori në prapësim konsideroj që nuk janë relevante në këtë procedurë sepse në procedurë penale kemi të bëjmë me vjedhje të shërbimeve pra ku është kryer dëm material (kompensim dëmi), ndërsa në procedurën përmbarrimore kemi të bëjmë me borxhin e krijuar nga shfrytëzimi i energjisë elektrike. Andaj propozojmë nga gjykata që prapësimin e debitorit ta hedhë si të pa bazuar në ligj dhe urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi. Shpenzimet e procedurës përmbarrimore i kërkojmë sado që do të bëhen ato.

**I autorizuari i debitori av A.A., ka deklaruar:** Në tërësi qëndroj pranë pretendimeve si në prapësim, konsideroj se detyrimi i kërkuar nga kreditori është pa bazë juridike. Pa bazueshmëria juridike e detyrimit vërtetohet nga provat e bashkangjitura në prapësim të datës 21.08.2023, përmes të cilave vërtetohet se i njëjti nuk ka shfrytëzuar, qëndruar në objektin në të cilën gjendet njehsori si dhe nuk është vërtetuar dhe as përgjegjësia e tij për shkaktimin e dëmit ndaj kreditorit. Konsiderojmë se kreditori fillimisht duhet ta rregullojë propozimit sa i përket legjitimitetit pasiv të palës, për shkak se në këtë çështje përmbarrimore nuk e ka precizuar saktë se a është debitor K.Z., apo (Qerdhja- DKA), këtë fakt e bazojmë në konkluzionin e Komunës së Prizrenit – Drejtoria për çështje pronësore juridike me numër 03/3 – 466-17 e datës 10.04.2006 mbi lejimin e ekzekutimit të

bashkangjitur prapësimi për faktin se debitori është shpërngulur nga ky objekt, gjithashtu duhet të cekim se objekti nuk evidentohet si pronësi e debitorit K.Z., por në emër të Çerdhes – DKA në Prizren, kurse njehsori është i regjistruar në emër të tij deri sa ka qenë shfrytëzues i atij objekti përkatësisht para shpërnguljes së tij. Për të vërtetuar faktin se debitori nuk ka qëndruar në objektin në fjalë gjatë periudhës që pretendon kreditori, Gjykatës dhe kreditorit ia dorëzoj si provë edhe kontratën mbi shitblerjen e banesës në mes të Fa.C., si shitëse dhe L.Z., si blerëse përndryshe bashkëshortja e debitorit – kontratë e lidhur në Prizren me datë 17.05.2010, me të cilën vërtetohet se debitori prej vitit 2010 banon në adresën e cekur si në kontratë dhe që vërtetohet edhe nga fatura e cila lëshohet nga kreditori KESCO në emër të L.Z.,– këtu bashkëshortja e debitorit K.Z., ku gjykatës dhe kreditorit ua dorëzoj nga një kopje të kësaj fature. Andaj konsideroj se pretendimet e kreditorit që energjinë elektrike gjatë periudhës së cekur në propozim të përmbartimit e ka konsumuar debitori nuk qëndron, për faktin se edhe nga vetë deklaratat e përfaqësuesit të kreditorit në këtë seancë, është vërtetuar se të njëjtit asnjëherë nuk kanë verifikuar se kush në të vërtetë e shfrytëzon objektin dhe shpenzon energji elektrike, e sidomos nëse shikojmë ekstraktin e konsumatorit nuk është e pranueshme që një amvisëri të shpenzojë energji elektrike me shuma mujore prej mbi 200 apo 300 euro. I propozoj Gjykatës që prapësimin e debitorit ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ta lë jashtë fuqie urdhrin për përmbartim të përmbartuesit privat P.nr.141-23 i datës 23.03.2023 dhe propozimin për përmbartim ta refuzojë si të pa bazuar dhe ta obligojë kreditorin që të i kompensojë shpenzimet procedurale dhe atë: për përpilimin e prapësimi shumë prej 104 euro, taksën gjyqësore 30 euro dhe seancën në shumën 135 euro – të gjitha këto në shumën prej 269 euro, sipas tarifës së OAK.

Pas shqyrtimit të pretendimeve, të debitorit të paraqitur në prapësim dhe deklaratimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas mbajtjes së seancës dëgjimore, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se, **prapësimi është i bazuar.**

Me shikim në shkresat e lëndës së përmbartuesit Privat P.nr.141/2023, kjo gjykatë konstaton se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozimin për përmbartim të dokumentit të besueshëm dhe për përmbushjen e detyrimit të lartcekur në të holla dhe se çka është një vendim gjyqësor, bëhet fjalë në nenin 29 par.1 pika 1.2. Me shikim në dokumentin të besueshëm – ekstrakti nga librat afariste për borxhin në shumën prej 8,759.82 euro, ndërsa në cilësi të debitorit është shënuar K.Z., (..... – DKA)/ ....., në Prizren.

Kjo gjykatë konstaton se pas shikimit të shkresave të lëndës, propozimit për përmbartim, shkresave të lëndës dhe provave, debitori është i emëruar si K.Z., (..... – DKA), në rastin konkret, debitori K.Z., nuk e ka krijuar borxhin e kërkuar nga ana e kreditorit edhe pse njehsori figuron në emër të të njëjtit, e në situatën faktike shfrytëzues i hapësirës apo lokalit është Çerdhja në kuadër të Drejtorisë Komunale të Arsimit, ndërsa debitori nuk banon në atë adresë dhe nuk janë krijuar shpenzimet si pasojë e përdorimit të energjisë elektrike nga i njëjti. Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1722/18 i datës 04.02.2022, gjykata gjeti se ndaj këtu debitorit është refuzuar aktakuza për shkak se prokurori ka hequr dorë nga akuza. Nga konkluzioni për lejimin e ekzekutimit, i datës 10.04.2006 me numër të lëndës 03/3-466-17, Gjykata gjeti se debitori K.Z., është shpërngulur nga banesa – pronë e Çerdhes e cila menaxhohet nga DKA –ja, andaj nga kjo datë debitori nuk ka banuar në këtë adresë, ashtu që i njëjti nuk i ka krijuar shpenzimet e energjisë elektrike sipas urdhrin për përmbartim. Nga këto prova të administrua, Gjykata vërtetoi se debitori nuk ka

legjitimitet pasiv të jetë palë në procedurën përbarimore e as më pak të ngarkohet me borxhin sipas urdhrin për përbarim. Andaj në mungesë të legjitimitetit pasiv të palës debitore, ky dokument i besueshëm nuk mund të zbatohet.

Në kuadër të asaj se çka duhet të përmbajë një propozimi për përbarim dhe caktimin e përbarimit dhe aktvendimi për përbarim, bëhet fjalë në nenin 38 të LPP-së, thuhet se: *“Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor ..... kërkuesi i përbarimit dhe debitori, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti me anën e të cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit”*, ndërsa në nenin 43 theksohet: *“Aktvendimi për përbarim dhe urdhri për përbarim 1. Në aktvendimin për përbarimin dhe urdhrin për përbarim në bazë të titullit përbarues duhet të tregohet dokumenti përbarues, kreditori dhe debitori i përbarimit, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përbarimit, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përbarimit.”* .

Andaj me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë vendosi që ta aprovoj tërësisht të bazuar prapësimin e debitorit të përbarimit K.Z., nga Prizreni, të ushtruar kundër urdhrin për përbarim, P.nr.141/2023 të datës 23.03.2023, të përbaruesit privat Enis Hoxha nga Prizreni, të njëjtin urdhër e anuloj, dhe procedurën përbarimore në këtë çështje e përfundoi.

Prandaj nga ajo që u theksua më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 3, 69, 71, 73, 76 dhe 66 par.3 të LPP-së.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PPP.nr.102/2023 datë 06.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Sami Gashi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.